31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një **certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një **certifikatë të pranimit të përkohshëm** jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimi të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimi përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- (f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektues do të lëshojë një certifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.		
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.	
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.	
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 45,000.00 Euro e vlerës kontratës për 37 muaj	
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi,	

		kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar	
Pagesat		Ne situacione sipas raportit të menaxherit	
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.	
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.	
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës.	
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>36 muaj</i>	
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit].	
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës	
	24	Kërkesat për pagese do të bëhen punët e ekzekutuara në baza mujore (ex post). Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për punët e ekzekutuara në baza mujore (ex post).	
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake	
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklarates së Ilogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve për 2 vite .	
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.	
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuere e defekteve është 2 vite	
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.	
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë	

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
--	------	---

RENOVIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË OBJEKTET SHËNDETËSORE DHE

Nr	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH (€)	Shuma me TVSH (€)	shfrytëzimi i buxhetit ne % per secilin pozicion	%
A	PUNËT NDËRTIMORE						
1	PUNIMET PËRGADITORE						1.70%
1.1	Rrethimi i punishtes, gardh jotransparent i perkohshem me lartesi h=1.8m, në tërë perimetrit e caktuar të punishtes dhe shenjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2.0m, të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina. Në çmim të llogaritet edhe shenjat lajmëruese për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë.	m'	1.00	€ 10.00	€ 10.00	€	0.17
1.2	Shkyqja e përkohëshme e instalimeve eksistuese si dhe rikyqja e tyre pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe preventivi i konzervimit të instalimeve egzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.	komplet	1.00	€ 10.00	€ 10.00	€	0.17
1.3	Pastrimi i objektit, pozicioni përfshinë, grumbullimin, paketimin si dhe largimin e të gjitha paisjeve medicinale dhe medikamenteve të vjetra nga objekti deri në vendin e caktuar nga organi mbikqyrës. Vërejtje: Pasi që paisjet dhe medikamentet egzistuese paraqesin rrezikshmeri të lart ndaj shëndetit si dhe mjedisit në çmim duhet të parashihen të gjitha shpenzimet për siguri në punë, transportin si dhe deponimin e tyre nën kushte të veçanta në përputhje me udhëzimet të dhëna nga MMPH.	komplet	1.00	€ 30.00	€ 30.00	€	0.51
1.4	Pastrimi i objektit - pozicioni përfshinë, grumbullimin, paketimin si dhe dislokimin me kujdes e të gjitha paisjeve medicinale dhe medikamenteve, të cilat mund të përdoren prap, nga objekti deri në vendin e caktuar nga organi mbikqyrës. Ky pozicion vlen për paisjet të cilat mund të përdoren prap, prandaj duhet të dislokohen për një kohë të caktuar, derisa të përfundohet renovimi i objektit brenda (hapësirave) dhe të njëjtat të kthehen në pozitë të cilat janë të caktuara me projekt të ri të renovimit. Vërejtje: Pasi që paisjet dhe medikamentet egzistuese paraqesin rrezikshmeri të lart ndaj shëndetit si dhe mjedisit në çmim duhet të parashihen të gjitha shpenzimet për siguri në punë, transportin si dhe deponimin për një kohë të caktuar në vendin e caktuar nga organi mbikqyrës, nën kushte të veçanta në përputhje me udhëzimet të dhëna nga MMPH, si dhe kthimin e tyre në pozitën e paraparë me projekt të ri të renovimit.	komplet	1.00	€ 30.00	€ 30.00	€	0.51
1.5	Pastrimi i objektit, pozicioni përfshinë, grumbullimin, paketimin si dhe largimin e të gjitha paisjeve jomedicinale siq janë cisternat e naftës të cilat janë shfrytëzuar për ngrohje qendrore dhe elemente tjera të panevojshme për objektet dhe transporti i tyre deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës.	komplet	1.00	€ 30.00	€ 30.00	€	0.51
1.6	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material për ndërtimin e rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyrën e menaxhimit të projektit.	komplet	1	€ 50.00	€ 50.00	€	0.85

1.7	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore , zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit dhe renovimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektroteknike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit (rrjeti elektrik , rrjeti i ujësjellësit, kanalizimit etj.)	komplet	1	€	20.00	€	20.00	€	0.34
1.8	Inqizimi gjeodezik i lokacionit. Sip. Sp. teknik, (vetëm për objektet e reja)	paushall	1.00	€	30.00	€	30.00	€	0.51
1.9	Pas përfundimit të punimeve të gjitha ndërtimet e perkohshme duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit të renovuar si dhe terenit.	komplet	1.00	€	20.00	€	20.00	€	0.34
Totali:				€	230.00	€	230.00	€	0.99

2	PUNËT E DEMOLIMIT								10%
2.1	Demolimi i mureve ekzistuese me trashësi të ndryshme nga bllokat, tullat, pllakat e gipsit, ndarja me qelq e përforcuar me profile të metalit, etj, sipas pozicioneve të përcaktuara me projekt. Pozicioni përfshinë demolimin e mureve dhe instalimeve elektrike dhe instalimeve tjera që gjenden në të, si dhe bartja e tyre deri në deponinë e caktuar nga organet komunale, jo më pak se 5km.	m²	1	€	12.00	€	12.00	€	1.20
2.2	Demolimi i dyerëve dhe dritareve ekzistuese nga materiali i drurit, aluminit dhe PVC-së. Pozicioni përfshinë demolimin dhe bartjen e tyre deri në deponinë e caktuar nga organet komunale.	cope	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.3	Demolimi, pastrimi i dyshemës nga pllaka e qeramikes, llaminatit apo nga ndonjë material tjetër, për përgatitjen e shtresave të reja të objektit. Të gjitha dyshemet që do të demolohen të llogariten me të gjitha shtresat deri në pllakën e betonit duke përfshirë edhe gypat e ujit dhe kanalizimit dhe instalimeve tjera nëse ka si dhe pastrimi me presion me ajër. Të përgatitet hapësira për vendosjen e dyshemës së re me të gjitha instalimet e nevojshme në të. Në pozicion të parashihet edhe transporti deri në deponinë e caktuar nga organet komunale.	m²	1	€	7.00	€	7.00	€	0.70
2.4	Demolimi, pastrimi i mureve nga pllakat e qeramikes apo nga ndonjë material tjetër, për përgatitjen e shtresave të reja në mure. Të gjitha demolimet të llogariten me të gjitha shtresat deri në blloka ose tulla duke përfshirë edhe gypat e ujit dhe kanalizimit dhe instalimeve tjera nëse ka si dhe pastrimi me presion me ajër. Të përgatitet hapësira për vendosjen e pllakave të reja me të gjitha instalimet e nevojshme në të. Në pozicion të parashihet edhe transporti deri në deponinë e caktuar nga organet komunale.	m²	1	€	7.00	€	7.00	€	0.70
2.5	Demolimi (grryerja) e sipërfaqes së ngjyrës, gletit dhe suvatimit në vendet ku shihet e nevojshme (ku është e dëmtuar dhe nuk ka aftësi mbajtëse) në sipërfaqet e mureve të brendshme. Pozicioni përfshinë edhe pastrimin e punishtës gjatë gjithë kohës së realizimit të këtijë aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave deri në deponinë e caktuar nga organet komunale.	m²	1	€	4.00	€	4.00	€	0.40
2.6	Demolimi (grryerja) e sipërfaqes së ngjyrës, gletit në sipërfaqet e tavanit, si dhe suvatimit në vendet ku shihet e nevojshme një gjë e tillë(ku është e dëmtuar dhe nuk ka aftësi mbajtëse) . Pozicioni përfshinë edhe pastrimin e punishtës gjatë gjithë kohës së realizimit të këtijë aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave deri në deponinë e caktuar nga organet komunale.	m²	1	€	4.00	€	4.00	€	0.40

2.7	Demolimi (grryerja) e sipërfaqes së ngjyrës, gletit dhe të gjitha shtresave në sipërfaqet e mureve të jashtme duke e përfshirë edhe suvatimin deri në sipërfaqen e murit(blokave, tulla, etj). Pozicioni përfshinë edhe pastrimin e punishtës gjatë gjithë kohës së realizimit të kësaj aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave deri në deponin e caktuar nga organet komunale.	m ²	1	€	3.00	€	3.00	€	0.30
2.8	Çmontimi i elementeve në banjot si dhe kuzhinat , në pozicion përfshihet heqja e të gjitha elementeve të cilat gjenden në hapësirat e banjove dhe kuzhinës. Largimi dhe deponimi i këtyre elementeve të cilat janë në gjendje të mirë të përcaktohet nga organi mbikqyrës se ku të dërgohen, ndërsa elementet e panevojshme të dërgohen në deponi jo më afër se 5km.	copë	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.9	Demoli i gardhit mbrojtës ekzistues nga profilet e çelikut në hyrje të objektit siq janë: shkallë, rampë si dhe gardhi i shkallëve brenda objektit. Pozicioni përfshinë edhe transportin e mbeturinave deri në deponin e caktuar nga organet mbikqyrëse.	m'	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.1	Demolimi i radiatorëve, trupave ngrohës dhe tubave të nxemjes me të gjithë pjesët mbajtëse si dhe kthimi dhe montimi i tyre në vendet e parapara me projekt të ri pas kryerjes së renovimit. Kjo nënkupton demolimin me kujdes të tyre, duke mos i dëmtuar si dhe sanimin e dëmtimeve eventuale gjatë demolimit, çfardo qofshin ato duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme. Ky pozicion bëhet për kryerjen e punëve siq janë grryerja e shtresave të murit, si dhe vendosjen e re të shtresave duke përfshi suvatimin, masën rrafshuese, glet masën si dhe ngjyrosjen në sipërfaqet e mureve, si dhe kthimin e radiatorëve në vendin e paraparë me projekt. Në pozicion të parashihet edhe gypat shtesë me të gjitha elementet përcjellëse, në rast se parashihet të dislokohet nga vendi aktual radiator.	copë	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.11	Demolimi i radiatorëve, trupave ngrohës dhe tubave të nxemjes me të gjithë pjesët mbajtëse. Kjo nënkupton largimin me kujdes të tyre, si dhe sanimin e dëmtimeve eventuale gjatë demolimit, çfardo qofshin ato duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme. Në pozicion të parashihet edhe transporti deri në deponin e caktuar nga organet komunale.	copë	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.12	Demolimi i instalimit elektrik, ku përfshihen të gjitha elementet e sistemit elektrik. Pozicioni përfshin edhe transportin e mbeturinave në deponi të caktuar nga organet mbikqyrëse komunale, jo më pak se 5km.	komplet	1	€	10.00	€	10.00	€	1.00
2.13	Demolimi i pllakave në terasat e jashtme, shkallët dhe rampat në objekt, grryerja të realizohet deri në shtresën e pllakës nga beton armeja. Në pozicion të parashihet edhe transporti i materialit të demoluar deri ne deponin e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	m ²	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.14	Demolimi i plafonit të varur amstrong, me të gjithë aksesoret për gjatësi, perimetri dhe varëset, duke i përfshi edhe trupat ndriqes. Demolimi të realizohet deri në pllakën e betonit. Sipërfaqja demoluese të llogaritet me m ² . Në pozicion të parashihet edhe transporti i materialit të demoluar deri ne deponin e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	Në m ²	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.15	Demolimi i plafonit të varur nga materiali i rigips pllakes, me të gjithë aksesoret për gjatësi, perimetri dhe varëset, duke i përfshi edhe trupat ndriqes. Demolimi të realizohet deri në pllakën e betonit. Sipërfaqja demoluese të llogaritet me m ² . Në pozicion të parashihet edhe transporti i materialit të demoluar deri ne deponin e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	m ²	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50

2.16	Demolimi i rrjetit të kanalizimit dhe rrjetit të ujësjellësit me të gjitha elementet përcjellëse fazonike brenda objektit. Në pozicion të parashihet edhe largimi i mbeturinave dhe transporti i tyre deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës.	m'	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.17	Demolimi i kujdesshëm i sistemit të monitorimit dhe alarmit kundër zjarrit duke përfshirë kamerat e sigurisë, monitorët dhe pjesë tjera në lidhje me të. Në pozicion të parashihet edhe transporti i materialit të demoluar deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	komplet	1	€	10.00	€	10.00	€	1.00
2.18	Demontimi i fasadës së jashtme dhe gryerja e saj në pjesën e murit të atikës së strehës dhe në pjesët tjera të mureve ku shihet e nevojshme një gjë e tillë. Në pozicion të parashihet edhe transporti i materialit të demoluar deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	m²	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.19	Demolimi i rrjetit të kanalizimit fekal të jashtëm ekzistues duke përfshirë gypat, pusetat, kapakët dhe elementet tjera përcjellëse. Në pozicion të parashihet edhe largimi i mbeturinave dhe transporti i tyre deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës.	m'	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.2	Rilokimi i hidrantëve të dalja emergjente dhe ne hapësirat tjera dhe vendosja e tyre në pjesën e paraparë me projekt.	copë	1	€	8.00	€	8.00	€	0.80
2.21	Demontimi i pikores së gjerë ekzistues dhe llamarinës mbi kulmin e hyrjes kryesore. Në pozicion të parashihet transporti i mbeturinave deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	m³	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.22	Demolimi i të gjitha shtresave të kulmit në pjesën e strehës në hyrje të objektit duke përfshirë llamarinën apo ndonjë material tjetër me të gjitha elementet përcjellëse, konstruksionin mbajtës dhe shtresat e hidroizolimit dhe termoizolimit deri në pllakën e beton armesë, për përgatitjen e shtresave të reja të objektit. Në pozicion të parashihet edhe largimi dhe transporti i tyre deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës.	m²	1	€	8.00	€	8.00	€	0.80
2.23	Demolimi i mureve për krijimin e hapësirave të pastërta me dimensione prej min. 90x210cm - max. 140x210cm, në bazë të nevojës të paraparë me projekt. Në rast se muri ekzistues është mbajtës demolimi bëhet në disa faza: 1 - krijimi i hapësirës për arkitra në anën e jashtme kah koridori deri në thellësi 18cm dhe lartësi 25cm dhe gjerësi deri në min.130cm - max180cm, ku do të vendoset profili HOP 200/15/4.2. 2 - krijimi i hapësirës për arkitra në pjesën e brendshme (dhoma) deri në thellësi 18cm dhe lartësi 25cm dhe gjerësi deri në min.130cm - max 180cm, ku do të vendoset profili HOP 200/15/4.2. 3 - Pas montimit të arkitrajeve bëhet demolimi i komplet murit për hapësirën e derës. Pozicioni përfshinë edhe largimin e mbeturinave deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km. Vërejtje: në cmim nuk është paraparë vendosja e arkitraut.	komplet	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.24	Demolimi i sallobankut, ulluqeve horizontale dhe vertikale, mbulojës së sipërme të murit të atikës me të gjitha elementet nga llarina. Pozicioni përfshinë demolimin dhe transporti deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	m'	1	€	5.00	€	5.00	€	0.50
2.25	Demolimi i mbulesës së kulmit dhe strehëve apo mbështjellës të strehëve, nga materiali i ndryshëm. Pozicioni përfshinë të gjitha shtresat e kulmit, konstruksionit si dhe transporti e tyre deri në deponinë e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	m²	1	€	8.00	€	8.00	€	0.80

2.26	Demolimi i trotuarit, rampës për hendikep si dhe pllakës beton arme apo kubëzave nga betoni rreth objektit dhe në oborr. Pozicioni përfshinë edhe transportin deri në deponin e caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km. Llogaritja e sipërfaqes bëhet në bazë të themelit.	m ²	1	€ 8.00	€ 8.00	€	0.80
2.27	Pastrimi i terenit, pozicioni përfshinë largimin e barishtave, shkurreve si dhe gërmimi deri në thellësi 30cm. Largimi i mbeturinave në deponi të caktuar nga organi mbikqyrës, jo më larg se 5km.	m ²	1	€ 5.00	€ 5.00	€	0.50
2.28	Demolimi i lavamanëve nga beton armeja në brendi të objektit dhe elementeve tjera që shihen të nevojshme të largohen nga vendpunishja dhe transporti i tyre deri në deponin e caktuar nga organi mbikqyrës.	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	€	0.50
2.29	Demolimi i fasadës së ventiliuar, duke i përfshirë në pozicion panelet e jashtme me të gjitha shtresat deri në shtresën e murit siq janë: termoizolimi, konstrukcionin mbajtës etj. dhe pastrimin e murit për vendosjen e shtresa të reja të fasadës. Materiali i demoluar duhet të largohet nga vendpunishja dhe transportohet deri në deponin e caktuar nga organi mbikqyrës.	m ²	1	€ 5.00	€ 5.00	€	0.50
2.3	Demolimi i pjesës së dëmtuar të fasadës së jashtme ose i tërë fasadës nëse një gjë e tillë shihet e nevojshme për tu bërë. Pozicioni përfshin: stiroporin, ngjitesin, suvatimin e jashtëm, deri te blloki, tulla, etj. dhe pastrimin e murit për vendosjen e shtresa të reja të fasadës. Materiali i demoluar duhet të largohet nga vendpunishja dhe transportohet deri në deponin e caktuar nga organi mbikqyrës.	m ²	1	€ 5.00	€ 5.00	€	0.50
2.31	Demolimi i punëve të paparashikuara me paramasë, por të cilat dalin gjatë demolimeve në objekt qoftë ai në murë, dysheme, etj.	paushall	1	€ 5.00	€ 5.00	€	0.50
2.32	Demolimi me kujdes (duke mos i dëmtuar) i ventilatorëve ekzistues dhe gypave të tyre me të gjitha elementet përcjellëse dhe montimi i tyre në vendin i cili është paraparë në projekt. Në çmim të parashihet dislokimi dhe montimi i ventilatorëve dhe gypave me të gjitha elementet përcjellëse, si dhe furnizimi dhe montimi i ndonjë materiali të ri i cili dëmtohet gjatë demolimit.	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	€	0.50
2.33	Demontimi dhe dislokimi i kompresorëve me të gjitha elementet përcjellëse. Të parashihet krijimi i një mbështjellësi (objekti strehues), për kompresorë në mënyrë që ta ruaj atë nga reshjet atmosferike nëse janë jashtë objektit. Në pozicion të parashihen edhe elementet tjera përcjellëse që të jetë funksionale dhe stabile.	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	€	0.50
				Totali:	194.00		2.40

3	Punët e gërmimit dhe nivelizimit						1%
3.1	Gërmimi i gjerë dhe rrafshimi i terenit, kjo përfshinë edhe transportin deri në vendin e caktuar nga organi mbikqyrës, në largësi jo më të vogël se 5 km.	m ²	1	€ 8.80	€ 8.80	€	0.09
3.2	Gërmimi i dheut të kategorisë së tretë për themele me dimensione sipas projektit, kjo përfshinë edhe transportin deri në deponin e caktuar nga organi mbikqyrës në largësi jo më të vogël se 5 km. Në çmim duhet të parashihet edhe ngjeshja e dheut.	m ³	1	€ 8.90	€ 8.90	€	0.09
3.3	Furnizimi dhe shtruarja e gjeotekstilit (300gr/m2), mbi sipërfaqen e ngjeshur të dheut.	m ²	1	€ 3.80	€ 3.80	€	0.04
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së rëres - fraksion 0-4 mm (në gjendje të ngjeshur) për mbulimin e gjeotekstilit.	m ³	1	€ 19.50	€ 19.50	€	0.20

3.5	Furnizimi, transporti dhe shtruarja e zhavorit kokërrmadh 0-60mm, me trashësi t=30 cm nën themelin shiritor, kjo përfshin edhe ngjeshjen e tij. (Vërejtje: Në qmim duhet të llogaritet edhe shqyrtimi i ngjeshjes nga ekipi i specializuar për këtë lëmi - min. 40MPa)	m³	1	€	18.00	€	18.00	€	0.18
3.6	Furnizimi, transporti dhe shtruarja e zhavorit kokërrmadh 0-31mm, nën pllaken e perdheses, me t=30cm, kjo përfshin edhe ngjeshjen e tij. (Vërejtje: Në qmim duhet të llogaritet edhe shqyrtimi i ngjeshjes nga ekipi i specializuar për këtë lëmi-min. 40MPa)	m³	1	€	18.50	€	18.50	€	0.19
				Totali:		77.50			0.78

4	Punët e Betonit dhe armatura								2%
	Vërejtje: Marka e betonit për të gjitha aktivitetet është C25/30. Të gjitha testet dhe shqyrtimet nevojshme të përfshihen në cmim (numëri i shqyrtimeve caktohet nga organi mbikqyrës). Lloji i armaturës të përdorura janë: S-500; Q-335 dhe Q-378.								
4.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve, si dhe armimi me armaturë të dhënë në fazën e statikës ose të përcaktohet nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtese)	m³	1		40.60	€	40.60	€	0.81
4.2	Furnizimi, transporti dhe betonimi i traut të serklazhit (cokllës). Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve, si dhe armimi me armaturë të dhënë në fazën e statikës ose të përcaktohet nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtese).	m³	1		40.80	€	40.80	€	0.82
4.3	Furnizimi, transporti dhe betonimi i pllakës mbi themel, me trashësi të dhënë sipas projektit apo të përcaktohet nga organi mbikqyrës. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve, si dhe armimi me armaturë të dhënë në fazën e statikës ose të përcaktohet nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtese).	m³	1		40.80	€	40.80	€	0.82
4.4	Furnizimi, transporti dhe betonimi i trajeve mbajtës të përcaktuar me projekt ose nga organi mbikqyrës. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve, si dhe armimi me armaturë të dhënë sipas projektit të dhënë në fazën e statikës ose të përcaktohet nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtese)	m³	1		40.80	€	40.80	€	0.82
4.5	Furnizimi, transporti dhe betonimi i arkitrajeve(trajet mbi dyer dhe dritare. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve si dhe armimi me armaturë të dhënë sipas projektit të dhënë në fazën e statikës, ose të përcaktohet nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtese).	m³	1		40.80	€	40.80	€	0.82
4.6	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtyllave me dimensione të përcaktuar me projekt ose nga organi mbikqyrës. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve si dhe armimi me armaturë të dhënë sipas projektit të dhënë në fazën e statikës, ose të përcaktohet nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtese)	m³	1		42.00	€	42.00	€	0.84

4.7	Furnizimi, transporti dhe betonimi i pllakës së meskatit me trashësi të përcaktuar me projekt ose nga organi mbikqyrës. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve. Në pozicion të përfshihet edhe armimi i dhënë sipas fazës së statikës, ose të përcaktohet nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtesë)	m³	1	40.60	€	40.60	€	0.81
4.8	Furnizimi, transporti dhe betonimi i brezave të kallkanit të kulmit të objektit. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve. Në pozicion të parashihet edhe armimi i dhënë sipas statikës, ose të përcaktohen nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtesë)	m³	1	40.80	€	40.80	€	0.82
4.9	Furnizimi, transporti dhe betonimi me beton të varfër në pjesën nën shputë të themeleve me t=10cm.	m³	1	39.80	€	39.80	€	0.80
4.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shkallëve të jashtme ose të brendshme të specifikuar në projekt. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve për punimin e shkallëve, e specifikuar në fazën e statikës. (Shiqo vizatimet shtesë)	m³	1	40.10	€	40.10	€	0.80
4.11	Furnizimi, transporti dhe betonimi i rampave. Në pozicion të parashihen këto punë: punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, vibrimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve. Në pozicion të parashihet edhe armimi i dhënë sipas projektit të specifikuar në fazën e statikës, ose të përcaktohet nga organi mbikqyrës. (Shiqo vizatimet shtesë)	m³	1	40.10	€	40.10	€	0.80
